

VENDIM
Nr. 818, datë 18.12.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KORÇË, TË PRONËS NR. 545, ME EMËRTIM "AERODROM FUSHOR", ME VENDNDODHJE NË KORÇË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Korçë, të pronës nr. 545, me emërtim "Aerodrom fushor", me vendndodhje në Korçë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 545, me emërtim "Aerodrom fushor", me vendndodhje në Korçë, sipas planrilevimit.

3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI	
Prona nr.545, "Aerodrom fushor", Korçë	
MIRATOHET Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore Kolonel EDITSON ZARKA  PUNOI Majori Rudina GJOGU  Shtator 2019 SHPJEGUËSE Sipërfaqja e përgjithshme= 480559 m² Kufiri i pronës	ZV/DIREKTOR I GJIU Ark. ENEA SINOIMERI   IDENTIFIKIMI Zona Kadastrale Nr. Pasurisë Indeksi i Hartës K-34-126-(8-B) Shkalla 1: 11 00 Adresa e pasurisë Lumalas, Korçë Pronari : Ministria e Mbrojtjes
